

KOMPLEKS, TURBULLUES,  
POTHUAJSE I PADUKSHEM,  
PASIONUES, DHE...  
I KEQKUPTUAR!

# AUTIZMI




Gjithçka që familjet e  
njerëzve me autizëm kanë  
dashur t'ju tregojnë po t'u  
ishte krijuar mundësia!

Autisme Genève është një shoqatë e krijuar nga prindërit në vitin 2007. Shoqata ka më shumë se 600 anëtarë (persona autistë, familje dhe profesionistë) dhe vizioni i saj është krijimi i një bote më gjithëpërfshirëse, e cila mirëpret ndryshimin dhe u përshtatet nevojave të personave më të cënuar.

Misioni i saj është të:

- Bëjë gjithçka për ta bërë shoqërinë tonë më gjithëpërfshirëse;
- Ndërgjegjësojë publikun për karakteristikat e autizmit;
- Dëgjojë personat që janë brenda spektrit të autizmit dhe familjet e tyre, t'i informojë për autizmin dhe të mbrojnë të drejtat e tyre;
- Ofrojë trajnime profesionistëve për të garantuar mbështetje të përshtatur me nevojat e posaçme të secilit person të prekur nga autizmi;
- Sigurojë të gjitha informacionet dhe mjetet që do t'u mundësojnë familjeve të kuptojnë dhe mbështesin fëmijët e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme.

Na kontaktoni për çdo informacion:  
[secretariat@autisme-ge.ch](mailto:secretariat@autisme-ge.ch)



Ajnshtajni, Bill Gates, Glenn Gould, kaq shumë shembuj të figurave të famshme që dyshohet se kanë autizëm! Në ekstremin tjetër ne shohim një fëmijë të murosur në heshtjen e tij, dhe që vërtitet përpara një muri... Por mes shkëlqimit dhe derës së mbyllur, ekziston një botë e tërë! Një botë ku personat autistë janë të padallueshëm, pothuajse të zakonshëm... Mund të jetë kolegu juaj i punës që është disi i tërhequr ose fqinji juaj që nuk të përshëndet natyrshëm, ose shoku i klasës i fëmijës suaj që duket pak i trazuar. Afërsisht një person në njëqind lind me autizëm. Për të qenë më të saktë, bëhet fjalë për çrregullimet e spektrit të autizmit (ÇSA), por, për ta thjeshtësuar, ne po përdorim termin “autizëm”.

Pra, çfarë kanë të përbashkët këta njerëz?

Të gjithë kanë:

- Vështirësi në kuptimin dhe asimilimin e shprehive shoqërore të nevojshme për jetesë në shoqëri;
- Ndjeshmëri të veçantë ndaj lëvizjes, prekjes, zhurmës, dritës ose shijes;
- Interesa të veçanta shqisore ose intelektuale;
- Nevojë të madhe për rregull;
- Në shumë raste, vështirësi të mëdha në kontrollin e emocioneve të tyre, si dhe për të kuptuar e për t'u përshtatur me mënyrën e paparashikueshme dhe shpesh të palogjikshme të sjelljes së njerëzve pa autizëm!





## Personat me autizëm nuk janë të sëmurë, dhe më e mira është se nuk është ngjitës!

Nëse mendoni se autizmi është sëmundje, mendohuni sërish! Një fëmijë lind autist dhe mbetet i tillë për gjithë jetën. Autizmi është një çrregullim i zhvillimit nervor me disa faktorë gjenetikë që shkaktojnë zhvillimin atipik të trurit. Në shumicën e rasteve, zbulimi, mundësisht herët, dhe mbështetja e veçantë mund t'i ndihmojë njerëzit me autizëm të zhvillohen dhe të gjejnë më lehtë vendin e tyre në shoqëri. Ne na mbetet t'i pranojmë sa më mirë!

## Kur zhurma e tharëses së flokëve bëhet torturë...

Kur shihni fëmijë që mbyllin veshët për të mbytur një zhurmë, mendoni se si ata vërtet mund ta përjetojnë një zhurmë të padëmshme si ajo e tharëses së flokëve si një goditje fizike e dhimbshme. Ky lloj i veçantë perceptimi është i gjithëpranishëm dhe shpjegon disa sjellje të papritura. Ndjeshmëria e skajshme ndaj zhurmës mund ta bëjë zhurmën e zakonshme të padurueshme, takimi i bluzës me lëkurën mund të perceptohet si letër zmerile. Të gjithë këto stimulues të sistemit nervor mund të bëhen shumë stresues dhe rraskapitës. Në ekstremin tjetër, ndjeshmëria e skajshme mund të shkaktojë sjellje që mund të arrijnë deri në vetë-dëmtim.





## Shumë autistë po flasin dhe ata kanë shumë për t'ju treguar!

Shpeshherë, mendohet gabimisht se njerëzit autistë nuk flasin dhe kjo nuk është e vërtetë! Shumica e njerëzve me autizëm mësojnë të flasin. Disa fëmijë kanë nevojë për mbështetje që të mësojnë të flasin dhe fillojnë të flasin më vonë sesa pritej. Intonacionet që ndryshojnë, gabimet në ndërtimin e fjalive ose prania e fjalëve të përdorura rrallë të japin përshtypjen se personi nuk flet gjuhën e nënës. Duhet theksuar se njerëzit që kanë aftësi të kufizuara gjuhësore nuk kanë gjithmonë aftësi të kufizuara intelektuale.



## Mjaft më!

Nëse imagjeroni që fëmija që rotullohet në dyshe-menë e një supermarketi sepse nëna nuk pranon t'i blejë një tortë me luleshtrydhe është i padurueshëm dhe i paedukuar, mendohuni sërish: ai mund të jetë autist. Nga mënyra si e sheh ai situatën: mbase ai mendon se po ndëshkohet padrejtësisht dhe se nuk do të lejohet më të hajë tortë me luleshtrydhe. Një situatë që ne na duket e rëndomtë mund të mos jetë kështu për të. Ambienti hiperstimulues i supermarketit e zmadhon reagimin e tij.



# Të perceptohen, kuptohen dhe merren parasysh emocionet e të tjerëve, jo aq e lehtë!

Edhe për njerëzit e ashtuquajtur “neurotipikë” (jo-autistë), kuptimi, interpretimi dhe kontrolli i emocioneve nuk është gjithmonë i lehtë! Për një person me autizëm, është njësoj si gjuha kineze. Për më tepër, këta persona mund ta mësojnë kinezçen më kollaj! Manifestimet e emocioneve tona atyre mund t’u duken të palogjikshme. Një fëmijë me autizëm që trishtohet kur sheh nënën e tij që qesh me lot nuk do të tregojë simpati kur të shohë një shoqe duke qarë, thjesht për shkak se nuk kupton ç’po ndodh. Përveç kësaj, njerëzit me autizëm mund të preken nga shqetësimet e të afërmeve të tyre, por mund të mos dinë si ta shprehin solidaritetin e tyre.





## Kokëçarja nga normat shoqërore...

Disa njerëz me autizëm mund të tregojnë pak interes për ata që kanë përreth, ndërkohë që disa të tjerë mund të jenë shumë të shoqërueshëm. Por edhe këta të fundit mund të kenë vështirësi të mëdha në kuptimin dhe zbatimin e kodeve shoqërore. Këto kode, të cilat ne i mësojmë pothuajse instiktivisht, njerëzit me autizëm i mësojnë vetëm pas një procesi të gjatë praktikimi. Sa larg duhet të qëndrojnë dy bashkëbisedues gjatë një diskutimi? Pse duhet ta mbajmë derën që të kalojë një femër? A është më mirë që kur të përshëndesin duke të thënë “Mirëdita, si jeni?” të japësh hollësi të gjendjes suaj shëndetësore, apo të thuash thjeshtë, “Mirë, po ju? “?

## Po sikur t'u përbahemi planeve? Thjesht?

Njerëzit me autizëm shpesh ndjehen më të sigurtë kur i përbahen një rutine, ata duan të dinë si është planifikuar dita dhe të kenë orare të caktuara. Edhe një ndryshim i vogël në rutinë mund të jetë shumë stresues për personat me autizëm dhe mund të kërkojë përpjekje të mëdha nga ana e tyre për të kuptuar ç'po ndodh dhe për të ri-planifikuar. Informacioni i paraqitur në formë pamore (foto, informacion i shkruar) ndihmon në zvogëlimin e këtij stresi.





## Pasione gllabëruese për tema të mahnitshme!

Pavarësisht nga lloji i autizmit, interesat e veçanta janë shumë të rëndësishme dhe mund të bëhen dominuese. Truri i specializuar i personave me autizëm kërkon njohuri të thelluar të temave për të cilat ata janë të apasionuar. Atyre shpesh u pëlqen përsëritja. Një njeri me autizëm mund të dijë çdo gjë për dinosaurët (dhe nuk mund të durojë që një person tjetër të bëjë edhe një gabim të vetëm në këtë fushë!), një tjetër kënaqet duke dëgjuar një këngë 1000 herë pa u lodhur. Mos e ngacmoni një person të apasionuar pas historisë së Japonisë së shekullit të 17-të, pasi ai mund të flasë me entuziazëm për orë të tëra për këtë temë, duke mos e vënë re lodhjen tuaj!

## Ka aq lloje autizmi sa edhe njerëzit me autizëm!



Çdo qenie njerëzore është unike dhe një person me autizëm nuk mund të përkufizohet nga veçantia e neuroneve të tij. Ai ka personalitetin, interesat, gëzimet dhe hidhërimet e tij. Por autizmi përfshin një familje të madhe njerëzish, me simptoma nga më të lehtat te më të rëndat, me aftësi pak ose tejet të kufizuara. Sidoqoftë, identifikimi i autizmit na lejon të kuptojmë më mirë veçoritë e sjelljes së një personi autist dhe kështu të përpiqemi t'i japim atij çelësat e botës sonë neurotipike, që për të nuk është shumë e rehatshme!





Njerëzit me autizëm i shohin gjërat ndryshe nga ne, ata hedhin dritë të re mbi ekzistencën tonë dhe na hapin sytë. Qeniet njerëzore priren të refuzojnë ndryshimin kur ai shpesh është sinonim i pasurisë së madhe! Ne ju ftojmë të zbuloni dhe mirëprisni neuro-diversitetin!

Kjo broshurë ndërgjegjësuere është hartuar nga shoqata Autisme Genève:  
**autisme-ge.ch**

Çdo person ose organizatë mund ta shpërndajë falas sipas liçencës  
CC BY-NCND 4.0.  

Për të mbështetur shoqatën e Autizmit në Gjenevë, ju mund të:

- Anëtarësoheni:  
[www.autisme-ge.ch/devenir-membre/](http://www.autisme-ge.ch/devenir-membre/)
- Jepni një donacion në llogarinë tonë:  
IBAN CH0900 788 0000 5044 2699

Vizatimet: Elvira David Coppex  
Ilustrime: Tom Tirabosco  
Grafikë: Raoul de Bazignan  
Përkthimi në shqip: Jonida Lushka

Kjo broshurë është prodhuar me mbështetjen e:



# autisme

## GENÈVE

Autisme Genève  
Rue de Villereuse 7  
1207 Genève  
Zvicra

[autisme-ge.ch](http://autisme-ge.ch)